



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 180, Datë 08.11.2017

MBI

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “b”; 20 gërma “a”; 108 dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 26 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin nr. 96 datë. 17 .06. 2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 08.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se,

- Drejtoritë teknike në bashkëpunim me konsulencën e USAID përgatitën dhe paraqitën në Bord në muajin shtator 2017 draftin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 157 date 28.09.2017 miratoi fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 100/49 Prot., datë 02.10.2017, ERE ka publikuar me median e shkruar njoftimin për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave transmetimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 651 Prot. datë 04.10.2017, ERE njoftoi OST sh.a., OSHEE sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Konfederatën e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Konfindustrian, AAES, AREA, FIAA, ACERC dhe Shoqatën e Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike dhe u kërkoi të paraqesin opinionet apo komentet e tyre në lidhje me këtë metodologji.
- OST sh.a. me shkresën nr. 5316/1 Prot., datë 13.10.2017, paraqiti në ERE komentet lidhur me draftin e propozuar të metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike të cilat u diskutuan edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE në datën 20.10.2017. Komenti i OST për përjashtimin e faturimit të

energjisë reaktive, u pranua duke u hequr edhe nga metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

- 1 Të miratojë metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.(Bashkëlidhur)
- 2 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.